



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE**  
**MBROJTES SË KONSUMATORIT *kp***  
**DPPB**

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 2, Tiranë, Tel - Fax (04) 222 86 21, www.mbu.gov.al

Nr 4/53 Prot.

Tiranë, më 9.09. 2008

**RREGULLORE**

Nr 4 datë 9.09. 2008

**PËR**  
**“STANDARTET PËR MBARËSHTIMIN E VIÇAVE”**

Në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve nr. 4, dhe 17 të ligjit nr 9426 dt.6.10.2005, “Për Mbarështimin e Blegtorisë” i ndryshuar, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nxjerr këtë rregullore:

Kreu I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton standartet për mbarështimin e viçave për rritje dhe majmëri (kushtet teknike-teknologjike për objektet e strehimit, pajisjet si dhe planifikimi i hapësirës së nevojshme).

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

- a) “viç”- kuptojmë një kafshë gjedhi deri 6 muaj.

Kreu II  
STANDARTET NË MBARËSHTIMIN E VIÇAVE

**Neni 4**  
**Akomodimi**

1. Materialet e përdorura veçanërisht bokset me të cilat janë në kontakt nuk duhet të janë të dëmshëm për viçat dhe duhet të janë të tillë që të mund të pastrohen dhe të dezinfektohen tërësisht.
2. Akomodimi për viçat duhet të bëhet në një mënyrë të tillë që sejcili viç të ketë mundësi të qëndrojë i shtrirë, në këmbë dhe të ushqejë vetveten pa vështirësi.
3. Viçat nuk duhet të janë të lidhur, me përjashtim të viçave të mbajtur në grup të cilët mund të lidhen për një kohë jo më shumë se një orë në kohën e të ushqyerit me qumësht ose zëvendësues qumështi. Kur përdoren litarë ose zinxhirë për lidhjen e tyre duhet të shmanget rreziku i mytjes dhe shkaktimit të plagëve. Lidhja duhet të lejojë një qëndrim të rehatshëm dhe lëvizje të lirë të viçave. Mjetet e lidhjes duhet të inspektohen rregullisht.
4. Asnjë viç nuk duhet të mbahet në një boks individual pas moshës 8 javëshe me përjashtim kur një veteriner rekomandon që shëndeti ose sjellja e tij e kërkon që ky të izolohet me qëllim për të marrë trajtim. Gjerësia e çdo boksi individual për një viç duhet të jetë të paktën e barabartë me lartësinë e viçit në xhidavi e matur në këmbë dhe gjatësia duhet të jetë e paktën e barabartë më gjatësinë e trupit të viçit e matur nga maya e hundës deri në kockën e bishtit e shumëzuar me 1.1.
  - a) Bokset individuale për viçat përjashtuar ata të izoluar si kafshë të sëmura nuk duhet të kenë mure të myllur por me vrima për të lejuar që viçat të kenë kontakt vizual me të tjerët dhe gjerësia e bokseve nuk duhet të jetë më pak se 90 cm plus ose minus 10%, ose 0.80 here me e larte se kreshta e kafshës.
  - b) Për viçat e mbajtur në grupe, sasia e hapësirës e disponueshme duhet të sigurojë që ata të rrotullohen dhe shtrihen pa pengesë. Për çdo viç me një peshë më pak se 150 kg duhet të jetë të paktën  $1.5 \text{ m}^2$ , me peshë 150 – 220 kg jo më pak se  $1.7 \text{ m}^2$  dhe për çdo viç me peshë 220 kg jo me pak se  $1.8 \text{ m}^2$  e lartë. Kjo nuk është e nevojshme të zbatohet për fermat me

më pak se 6 viçat ose viçat e mbajtur me nënënat e tyre për mëmëzim. Kushte të veçanta mund të zbatohen për:

- viçat, shëndeti apo sjellja e të cilëve kërkon që ata të izolohen nga grupi për të marrë trajtimin e duhur,
  - kafshët racë-pastër për përmirësim racor,
  - viçat që mbahen me nënënat e tyre për mëmëzim natyral,
  - viçat që mbahen në hapësirë të bollshme.
5. Dyshemetë duhet të jenë të sheshta por jo që të shkaktojnë rrëshqitje me qellim për të parandaluar dëmtimet ose të shkaktojnë vuajtje viçave gjatë qëndrimit shtrirë ose në këmbë. Ato duhet të jenë të përshtatshme për madhësinë dhe peshën e viçave dhe të formojnë një sipërfaqe të ngurtë, të sheshtë dhe të qëndrueshme. Shtrati duhet të jetë i rehatshëm, i pastër dhe që filtron jashtëqitjet e lëngshme. Shtresë e përshtatshme duhet të sigurohet për viçat e moshës më të vogël se 2 javë.

## **Neni 5** **Pajisjet elektrike**

1. Pajisjet elektrike duhet të instalohen në mënyrë të tillë që të shmangin goditjet elektrike.
2. Viçat nuk duhet të mbahen në errësirë. Për të plotësuar nevojat fiziologjike dhe të sjelljes së tyre duhet të plotësohen nevojat për ndriçim natyral ose artificial të përshtatshëm sipas ndryshimeve klimatike te vendit. Kjo duhet të funksionojë për një periudhë të paktën të barabartë me periudhën e ndriçimit natyral normalisht të disponueshëm nga ora 9.00 deri 17.00. Gjithashtu ndriçim i përshtatshëm ( i përhershëm ose i përkohshëm) duhet të jetë i disponueshëm për të bërë të mundur inspektimin e viçave në çdo kohë.
3. Izolimi ngrohja dhe ventilimi i ndërtesave duhet të sigurojë që qarkullimi i ajrit, niveli i pluhurave, temperatura, lagështia relative e ajrit dhe përqendrimi i gazrave të mbahen brenda limiteve të cilat nuk janë të dëmshme për shëndetin e viçave.
4. Të gjitha pajisjet mekanike ose të automatizuara shumë të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e viçave duhet të inspektohen të paktën një herë në ditë. Kur zbulohen defekte, këto duhet të riparohen menjëherë, ose në qoftë se kjo është e pamundur, duhet të ndërmerrin veprime përkatëse nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të të ushqyerit dhe ruajtjes së një ambienti të kënaqshëm, për të garantuar shëndetin dhe mirëqenien e viçave derisa defekti të riparohet.

Kur përdoret një sistem ventilimi artificial duhet të krijohen kushte për një sistem mbështetës të përshtatshëm për të garantuar një riventilim të mjaftueshëm për të ruajtur shëndetin dhe mirëqenien e viçave, në rastin e mosfunkcionimit të sistemit. Një sistem alarmi duhet të sigurohet për të sinjalizuar rritësit për defektin. Sistemi i alarmit duhet të testohet rregullisht.

## **Neni 6** **Pastrimi dhe dezinfektimi**

Stallat, pajisjet dhe mjetet e përdorura për viçat duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen për të parandaluar infeksionet dhe zhvillimin e organizmave që janë bartës të sëmundjeve. Fekalet, urina dhe ushqimet e pa ngrëna dhe të prishura duhet të hiqen sa më shpesh për të minimizuar erën e keqe dhe shmangjen e mizave ose minjve.

## **Neni 7** **Inspektimi dhe Trajtimi i viçave**

Të gjithë viçat e strehuar duhet të inspektohen nga pronari ose personi përgjegjës për kafshët, të paktën dy herë në ditë. Viçat e mbajtur jashtë duhet të inspektohen të paktën një herë në ditë. Viçat e sëmurë ose të plagosur duhet të trajtohen pa vonesë dhe trajtimi veterinar duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në qoftë se viçat nuk reagojnë ndaj kujdesit të rritësit. Kur është e nevojshme, viçat e sëmurë ose që kanë ndonjë plagë duhet të izolohen dhe të akomodohen duke i siguruar një shtrat të rehatshëm dhe të thatë.

## **Neni 8** **Trajtimi ushqimor i viçave**

1. Të gjithë viçave duhet tu sigurohet një dietë e përshtatshme sipas moshës, peshës, nevojave fiziologjike dhe sjelljes së tyre për të mundësuar një shëndet dhe mirëqenie të mirë. Për këtë ushqimi duhet të përmbajë hekur në sasi të mjaftueshme për të siguruar nivel mesatar të hemoglobinës në gjak me të paktën 4.5 mol/litrë dhe një racion ditor që të përmbajë një sasi minimale fibre për çdo viç të moshës mbi dy javë, sasi që duhet të rritet nga 50-250gr në ditë për viçat me moshë 8-20 javë. Viçave nuk duhet tu vihet hundëse.
2. Të gjithë viçat duhet të ushqehen të paktën dy herë në ditë. Kur viçat mbahen në grupe dhe nuk ushqehen ad libidum (sipas dëshirës) ose

nëpërmjet një sistemi automatik të të ushqyerit, çdo viç duhet të ketë të drejtën për tu ushqyer në të njëjtën kohë si me të tjerët në grup.

3. Të gjithë viçat me moshë mbi dy javë duhet tu sigurohet sasi e mjaftueshme uji të freskët ose të plotësohen nevojat edhe nëpërmjet pirjes së lëngjeve të tjera.  
Në kushtet e një moti të nxeh të ose për viçat që janë të sëmurë uji i pijshëm i freskët duhet të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohës.
4. Pajisjet e ushqimit dhe të ujit duhet të ndërtohen, të vendosen dhe të mbahen në mënyrë që kontaminimi i ushqimit dhe ujit të përdorur nga viçat të jetë minimal.
5. Çdo viç duhet të marrë kulloshtren sa më shpejt të jetë e mundur dhe disa herë në ditë. Për të siguruar sasinë e mjaftueshme të imunoglobulinave në gjak, viçat duhet të marrin kulloshter sa më shpejt pas lindjes, jo më vonë se 2 orë pas lindjes.

#### **Neni 9**

#### **Dokumenti shoqërues i trajtimit të viçave**

Viçat që importohen në vendin tonë duhet të shoqërohen përvèç dokumenteve te tjera edhe nga një certifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent i atij vendi, që vërteton se ata kanë pasur një trajtim të paktën të njëjtë me trajtimin që u bëhet atyre sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.

#### **Neni 10**

#### **Zbatimi**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtoria e Politikave të Prodhimit dhe Tregjeve Bujqësore dhe Inspektorët e Zooteknisë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në qarqe.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Jemin G.JA**